



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2409 Prot.

Tiranë, më 15 /07 /2026

V E N D I M

Nr. 22, datë 10.07.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË GJEOLGJIA
DHE MJEDISI, NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE, NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 179, datë 04.04.2022, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Modelimi 3D i strukturave gjeologjike duke përdorur metoda të inteligjencës artificiale (rrjetet neurale);
2. Arkitektura strukturore e baseneve ndërmallore në Albanidet e brenshme: implikime për formimin dhe kapjen e sistemeve të hidrogjenit natyror;
3. Modelim-Simulimi dhe optimizimi i metodave të veprimit në shtresë për maksimizimin e fitimit neto të produktit në rezervuarin karbonatik masiv të vendburimit të naftës-Amonice.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Gjeologjia dhe Mjedisi, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

